


# Sëmundja e copëzave të Lewyt

Sëmundja e copëzave të Lewyt është sëmundje e pandalshme e kujtesës e cila fillon në moshën 50-80 vjeçare. Quhet kështu për shkak të copëzave të Lewyt, të cilat janë grimca brenda qelizës nervore, e të cilat në këtë sëmundje grumbullohen në zonën kores së trurit. Nuk dihet shkaku i shpërthimit të kësaj sëmundjeje.



Sëmundjet e kujtesë gjithnjë ndikojnë në tërë familjen dhe rrethin e ngushtë. Sjelljet e personit ndryshojnë përgjatë sëmurjes. Kjo sëmundje është pak më shumë e përhapur te burrat se sa te gratë.

Shumë simptoma të kësaj sëmundjeje mund t'i mjekojmë me barna e gjithashtu edhe me terapi pa barna. Mjekimi i mirë si dhe rehabilitimi e mbështesin edhe kualitetin e jetesës.

## SIMPTOMA TË KËSAJ SËMUNDJEJE JANË ndër të tjerë




Shtangia e muskujve, vështirësia për fillimin e lëvizjeve dhe vështirësitë për të ecur



Halucinacionet, iluzionet optike si dhe interpretime të gabuara



Vështirësitë në konfigurim




Çrregullimet e vetëdijes, rrëzimet

Për nga simptomat, sëmundja e copëzave të Lewyt i përngjajnë deri diku sëmundje së Parkinsonit dhe ajo ka gjithashtu edhe disa tipare që vërehen te sëmundja e Alzheimerit. Telashet e kujtesës shtohen zakonisht pasi që sëmundja të ketë shkuar më tej. Nuk ekziston ndonjë mjekim parandalues, shërues ose ndalues i kësaj sëmundjeje, mirëpo për shembull kujdesi për gjendjen shëndetësore, trajtimi me barna sipas simptomave si dhe jeta aktive, personale e mbështesin përditshmërinë e personit të sëmurë.

# Trajtimi



Trajtimi dhe metodat rehabilituese planifikohen bashkë me personin e sëmurë dhe të afërmit e tij. Gjendja jetësore dhe nevojat e secilit janë të ndryshme nga të tjerët. Përcjellja e rregullt është e rëndësishme.



Gjatë trajtimit të kësaj sëmundjeje është me rëndësi trajtimi i mirë i gjendjes së përgjithshme shëndetësore, si p.sh. terapia adekuat me barna, ushqimi i shëndetshëm, trajtimi i depresionit, fizkultura aktive dhe shërbimet e ndryshme që mbështesin mirëqenien psikike.

## Sëmundja e copëzave të Lewyt



Shërbimet mbështetës dhe benificionet e ndryshme lehtësojnë përditshmërinë. Si benificione përpos tjerash janë kompensimi i barnave, ndihma për trajtim për pensionistë si dhe ndihma për kujdesin ndaj personit të afërm. Shoqatat e kujtesës ofrojnë aktivitete të llojllojshme.



Në fazën fillestare të sëmundjes është i rëndësishëm planifikimi i ardhmërisë. Vullneti dhe dëshirat e veta mund të shprehen për shembull me rastin e autorizimit të kujdestarisë për mbikëqyrje të favoreve, testamentit dhe dëshirës për trajtim.

Mbaje në mend që jeta nuk mbaron me diagnozën e sëmundjes së kujtesës. Pikëllimi dhe zhgënjimi janë ndjenja të natyrshme, por me sëmundjen me kalimin e kohës mund të mësohesh të jetosh jetë të mirë.

🕒 Kujdesu për vetveten, ti je i rëndësishëm.

### Lähteet:

[www.muistiliitto.fi](http://www.muistiliitto.fi)

[www.terveyskirjasto.fi](http://www.terveyskirjasto.fi)

[www.kaypahoito.fi](http://www.kaypahoito.fi)

Kuva ja taide: Karen Cipre  
[karencipre.deviantart.com](http://karencipre.deviantart.com)



Salon  
Muistiyhdistys ry  
Muistiliiton jäsen

